

**"FAB GROUP" SHPK  
RRUGA "PANORAMA", KULLA E BIZNESIT, TIRANË  
NIPT L41702005T**

---

**VENDIM**

**I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

Sot më datë 28.02.2022, ora 11:00, në adresën e selisë të Shoqërisë "Fab Group" sh.p.k të ndodhur në Rrugë "Panorama", Kulla e Biznesit, Njësia Bashkiake Nr. 9 Tiranë, Shqipëri, realizohet Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "Fab Group" sh.p.k, një shoqëri e së drejtës shqiptare me NUIS L41702005T.

Në mbledhje është i pranishëm ortaku:

- Z. Irfan Hysenbelliu, zotërues i 100% të kuotave të Shoqërisë;

Asambleja e Përgjithshme është mbledhur në respektim të dispozitave përkatëse të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar). Duke qenë se është i pranishëm ortaku që përfaqëson shumicë të mjaftueshme të kapitalit të shoqërisë për mbajtjen e kësaj mbledhje, do të konsiderohet se mbledhja do të vendosë në mënyrë të vlefshme mbi çështjet e rendit të ditës si më poshtë:

1. Dhënien e miratimit për raportin e vecantë të ekspertit kontabël të autorizuar Z. Armand Avdolli pajisur me nr. licence profesionale 298 nga Instituti i Ekspertëve të Autorizuar për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Fab-Group" sh.p.k. për bilancin ushtrimor të vitit 2021.
2. Dhënien e miratimit që shtesë kapitali nga të tjera të pagueshme (ortakë) në vlerën prej 66,680,466 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë, shtesë kapitali nga rezerva për investime në vlerën prej 322,843 (treqind e njëzet e dy mijë e tetëqind e dyzet e tre) Lekë dhe ulje kapitali nga rezultati i vitit ushtrimor 2021 në vlerën -148,328 (minus njëqind e dyzet e tetë mijë e treqind e njëzet e tetë) Lekë të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë duke e rritur këtë kapital. Kapitali pas zmadhimit bëhet 100,603,150 (njëqind milion e gjashtëqind e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë) Lekë.
3. Të ndryshme.

Ortaku prezent në mbledhjen e asamblesë, bazuar në dispozitat përkatëse të Statutit të Shoqërisë si dhe Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"( i ndryshuar).

Për sa më sipër:

**ASAMBLEJA E SHOQËRISË**

**VENDOSI:**

1. Të japë miratimin për raportin e vecantë të ekspertit kontabël të autorizuar Z. Armand Avdoli pajisur me nr. licence profesionale 298 nga Instituti i Ekspertëve të Autorizuar për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Fab-Group" sh.p.k. për bilancin ushtrimor të vitit 2021.
2. Të japë miratimin që shtesë kapitali nga të tjera të pagueshme (ortakë) në vlerën prej 66,680,466 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë, shtesë kapitali nga rezerva për investime në vlerën prej 322,843 (treqind e njëzet e dy mijë e tetëqind e dyzet e tre) Lekë dhe ulje kapitali nga rezultati i vitit ushtrimor 2021 në vlerën -148,328 (minus njëqind e dyzet e tetë mijë e treqind e njëzet e tetë) Lekë ta kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë duke e rritur këtë kapital. Kapitali pas zmadhimit bëhet 100,603,150 (njëqind milion e gjashtëqind e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë) Lekë.
3. Të autorizojë administratorin e shoqërisë, të depozitojë personalisht apo nëpërmjet një personi të autorizuar këtë vendim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për efekt të regjistrimit të tij.

Duke mos pasur asnjë gjë tjetër për të diskutuar, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë deklarohet e mbyllur në orën 11:30.

Konform rregullave statutore dhe ligjore ky vendim do të rregjistrohet menjëherë në Q.K.B.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

**Z.IRFAN HYSENBELLIU**

  
